



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.17

Prishtinë, më 8.5.2018, në orën 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, dhe Verica Çeraniq.

**Munguan:** Mufera Shinik dhe Albulena Balaj – Halimaj.

**Përfaqësues të tjerë:** Përfaqësues nga MASHT-i, KDI-ja dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

## **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017**

Ismajl Kurteshi, tha se diskutimet lidhur mbi raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore kanë përfunduar në mbledhjen e kaluar, njëkohësisht shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me këtë raport, duke thënë që raporti nuk i plotëson kushtet për miratim.

**Adem Mikullovc**i, tha se duhet kërkuar nga Këshilli një raport më të detajuar për punën e tyre gjatë vitit 2017.

**Teuta Haxhiu**, tha se ndihet e zhgënjyer nga bordi i këtij Këshilli, sidomos nga momenti kur ata si anëtarë të Këshillit, individualisht, të sjellin raporte voluminoze. Gjithashtu, ajo tha që raporti është shumë i cekët dhe nuk përmban informata mbi punën e një Këshilli që ka funksionuar për 3 vite dhe shtoi se mungon një koordinim në mes të departamentit dhe këshillit, mirëpo, nuk arsyetoi faktin që këshilli nuk i është drejtuar asnjëherë Komisionit për këtë problem.

**Nezir Cocaj**, theksoi se Raporti i Këshillit nuk është profesional dhe duhet kërkuar Këshillit që ta sjell një raport më profesional brenda një afati të caktuar.

**Abdyl Salihu**, tha se ky raport nuk pasqyron punën e Këshillit. Ka shumë hapësirë për plotësime e përmirësime sidomos tek pjesa e bashkëpunimit në mes institucioneve.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, tha se ky raport nuk duhet të miratohet për shkak se nuk i plotëson kushtet që duhet ti përmbushë një raport.

**Verica Ceranic**, tha se nuk e përkrah këtë raport.

Pas diskutimeve në lidhje me raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017, Komisionit me shumicë votash vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

### **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të mos e miratojë Raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës**

Anëtarët e Komisionit vazhduan me shqyrtimin nen për nen të Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

### **4. Të ndryshme**

**Ismajl Kurteshi**, propozoi që ditën e premte më 11 maj 2018, të organizohet një takim me përfaqësuesit e IOWA-s.

Ai gjithashtu propozoi që më 16 maj, në orën 10:00, të organizohet një takim në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamentit të Trashëgimisë Kulturore dhe Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me ç'rast do të diskutohet për gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe mosbashkëpunimin e tyre.

Më 15 maj 2018, Komisioni është i ftuar të marrë pjesë në hapje të Konferencës “Java e Shkencës”, në Hotelin Internacional, në organizim të MASHT-it.

Kurteshi tha se do të realizohet edhe një takim me MASHT-in edhe në Rektorat, në lidhje me konkluzionet e përfunduara nga dy tryezat që Komisioni i ka organizuar, njëren për arsimin parashkollor dhe tjetrën për arsimimin e personave me aftësi të kufizuara dhe pastaj të kërkohet nga MASHT-i zbatimi i atyre rekomandimeve.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45.

***E përgatiti:***

***Stafi mbështetës i Komisionit.***

Kryetari i Komisionit,  
Ismajl Kurteshi